



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;*

*dhe*

*NNT "LOSHI-DESIGN"-nga Istogu të cilën e përfaqëson, z. Valmir Loshi, nga Istogu, Komuna e Istogut, me Nr. Rexh. Biznesi, 70689324 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për pune e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

**MIRËMBAJTJA E OBJEKTIT TË KOMUNËS-Lot 2**

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-18 - 7027 - 5-2-1 / C159 lot 2</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 018 / 068 / 521</i>

### *Neni 1 Lënda*

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

**MIRËMBAJTJA E OBJEKTIT TË KOMUNËS -Lot 2**

## **Neni 2 Çmimi**

**2.1 Çmimi total i punëve MIRËMBAJTJA E OBJEKTIT TË KOMUNËS është: 19.444,44 €**

**dhe me fjalë: /Nëntëmbdhjetë mijë e katërqind e katërdhjetë euro 44/100**

**2.2. Oferta financiare e kontraktorit e datës: 12.10.2018 është pjesë integrale e kontratës dhe bazë për pagesën e kontratës.**

**2.3 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.**

**2.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.**

## **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

**3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:**

*Marrëveshja e kontratës;*

*Kushtet e Veçanta të Kontratës;*

*Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*

*Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;*

*Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);*

*Plani për menaxhimin e kontratës*

*Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi*

**3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.**

## **Neni 4 Komunikimet**

**4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit**

*Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

*4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.*



*4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.*

**Për: Autoritetin Kontraktues**

**Për: Kontraktuesin**

**Komunën e Istogut**

**"Loshi Desgn" Shpk**

<b>Emri:</b>	<b>Zizë Bujupaj</b>	<b>Emri:</b>	<b>Valmir Loshi</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Zyrtar Përgjegjës I prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>D r e j t o r</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data</b>	<b>12/11/2018</b>	<b>Data</b>	<b>12/11/2018</b>
<b>V u l a:</b>		<b>V u l a</b>	